

ËSHTË KËNAQËSI



TË JETOSH NË LIRI

UDHËHEQJA IU TAKON QYTETARËVE

AJETE (12), LABINOT (13), ALBIONA (12), RINARTA (12), IZAIM (13), HAKI (12)



Me bashkimin e fjalëve „demos“ dhe „kratos“ formohet fjala demokraci, që do të thotë udhëheqje e popullit. Se si udhëheq populli do ta mësoni në vijim

Sot erdhëm ta vizitojmë Punëtorinë e Demokracisë. Për ne kjo ishte një ditë e mrekullueshme, e mbushur me informata të reja. Njëra nga këto informata kishte të bënte me vendin ku demokracia ka lindur për herë të parë. Pra, në vitin 507 para erës sonë. Ky vend is-



hte Athina. Demokracia ka dy forma më të përhapura, të cilat janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet po ashtu në dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Në sistemin parlamentar, populli zgjedh me anë të votave deputetët. Pastaj, deputetët e zgjedhin Presidentin. Kurse, në sistemin presidencial, përveç Kuvendit, populli zgjedh me anë të votave edhe Presidentin e vendit. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, që nënkupton se populli zgjedh

përfaqësuesit e vet. E më pas ata në emrin e popullit zgjedhin udhëheqësit e tjerë.

Kështu, duke vazhduar me informatat e reja që mësuam sot, ndër të tjera përmendëm edhe elementet e demokracisë. Këto elemente që na bëjnë jetën tonë më të lehtë janë: liria, barazia, respekti, toleranca, paqja, etj. Në shtetin tonë, Kosovën, ne kemi të drejta të barabarta. Disa prej këtyre të drejtave janë: e drejta e votës, e punës, e arsimimit, e ushqimit të shëndetshëm, e argëtimit, e lëvizjes dhe e shprehjes së lirë, e kështu me radhë.

Ne e zbatojmë të drejtën e votës në shkollë. Në klasën tonë kryetarin e zgjedhim sipas votave të nxënësve. Kush merr më shumë vota, ai nxënës zgjedhet kryetar. Pas kryetarit, personi me më pak vota zgjedhet sekretar. Ndërsa, arkatari vjen i treti në radhë në bazë të numrit të votave. Ne jemi shumë të kënaqur që po e shohim demokracinë kosovare duke u zhvilluar.



Gazetarët e shkëlqyer të „Demos-ti“

NE, QYTETARËT E MEDVECIT JEMI AKTIV

MAJLINDA (12), ARBNORE (13), EGZONIT (12), VALDET (12), HASIME (12), REGENT (13)



Medveci është fshat në komunën e Lipjanit. Qytet ky i cili është i njohur me zona të gjelbërta dhe mjaft të bukura

Kur diskutohet për demokracinë dhe aktivizimin e qytetarëve e kemi shumë të lehtë të flasim, sepse kemi mjaftueshëm shembuj nga qytetarët e komunës sonë. Jo vetëm në komunën e Lipjanit, por edhe në zonat rreth saj ka aktivizim dukshëm të madh të qytetarëve. Një shembull i tillë, jemi edhe ne banorët e fsha-

personat në nevojë. Kohëve të fundit, brenda shkollës jemi duke organizuar klube të ndryshme, të cilat janë të udhëhequra nga vetë ne nxënësit.

Qëllimi primar i formimit të këtyre klubeve është vetëdijësimi sa më i madh i nxënësve dhe aktivizimi i tyre në disa prej fushave që janë me rëndësi për ne. Klubet të cilat i kemi formuar janë: klubi i futbollit, klubi i skijimit, klubi i aktrimit, klubi i pastërtisë, etj.

Pra, qytetaria aktive përfshin angazhimin e qytetarëve për të përmirësuar jetën në komunitet. Ajo është dëshirë e vullnet për të ndihmuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. Pa qytetari aktive nuk mund të kemi as nivel të lartë të demokracisë. Ndër vite është dëshmuar se vetëm me kontributin e pandalur të popullit, demokracia rritet. Andaj, e kemi detyrë dhe përgjegjësi ta duam, ta ruajmë dhe ta mbrojmë shtetin tonë demokratik. Mbesim me shpresën se gjithmonë do të tregohemi aktiv dhe do t'i ftojmë të tjerët për bashkëpunim.



Qytetarët aktiv ruajnë ambientin e tyre

tit Medvec, të cilët ndjejmë përgjegjësi të madhe për t'iu ndihmuar të tjerëve. Në mesin e këtyre qytetarëve, bëjmë pjesë edhe ne nxënësit, të cilët kemi ndërmarrë iniciativa pro qytetarisë aktive. Për shembull, ne nga vullneti ynë i mirë, shumë shpesh e pastrojmë ambientin e shkollës sonë. Po ashtu, ne vazhdimisht ndihmojmë të tjerët, si p.sh. të moshuarit, të vegjëlit dhe



Bëhuni aktiv si ne

RËNDËSIA E MEDIAS NË DITËT E SOTME

UKË (12), ERJON (12), ZEKIJE (17), LENDRON (12), ARLINDA (12), DRITON (11), ADRIAN (12)

Media është mjet informimi, i cili u shërben jo vetëm të rriturve, por të gjitha moshave

Jemi në vitin 2024, dhe shumë shpejt, në Kosovë do të kemi zgjedhje parlamentare. Unë quhem Erjon Ramadani dhe unë do të kandidoj si kandidat i pavarur. Ka vite që unë ëndërroj të bëhem një deputet. Ajo çka më bën mua kandidat të veçantë, për dallim nga të tjerët, është ideja ime për të fuqizuar sigurinë e shtetit tim. Këtë mendoj ta bëj duke formuar edhe ushtrinë e shtetit tonë. Tani që i kam mbushur 18 vjet dhe kam të drejtë të kandidoj, dua të paraqes planin tim tek qytetarët. Në këtë mënyrë, ata do të njoftohen për të dhe unë do të mund të marrë pëlqimin e tyre.

Plani im për të formuar ushtrinë e shtetit nuk ka të bëjë me dëshirën time për luftë. Përkundrazi, unë e dua paqen dhe pikërisht për këtë arsye, dua ta forcoj sigurinë e qytetarëve të shtetit tim. Qëllimi im është t'i shmangim sa më shumë konfliktet me shtetet e tjera, pasi që në demokraci nuk ka vend për konflikte.

Disa muaj më parë, unë vendosa që planprogramin tim ta shpalosja në rrjetin social „Twitter“. Vetëm disa orë pas publikimit të planprogramit tim, unë kam pranuar qindra dhe mijëra mesazhe të ndryshme. Ato ishin nga bashkëqytetarët e mi, të cilët ishin shumë të interesuar për atë që unë kam paraqitur në planin tim. Për një moment, u ndala dhe mendova, çfarë do të bëja po të mos ekzistonte interneti? A do të mund të

depërtoja kaq shpejt? Pas kësaj që ndodhi, unë u binda edhe më shumë për rëndësinë dhe vlerën e internetit dhe të medias në përgjithësi.

Plani im, ditë më vonë u paraqit edhe nëpër televizione, gazeta e radio të ndryshme të Kosovës. Kjo më siguroi bindshëm që unë do ta kem besimin e plotë të qytetarëve dhe ata do të më votojnë mua në këto zgjedhje parlamentare.

Fushata ime përfitoi shumë, si nga media elektronike, ashtu edhe nga ajo e shkruar. Ky është një shembull se si ne mund ta shfrytëzojmë internetin për gjëra të mira dhe të cilat do të sigurojnë fuqizimin e parimeve të demokracisë.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës



Duke mësuar shumë, gjasat rriten që në të ardhmen të jem një qytetar dhe një deputet i denjë për popullin tim të dashur

Në artikullin që sapo lexuat, ne theksuam rëndësinë e medias dhe mënyrën se si ne mund ta përdorim atë për gjëra pozitive, të cilat mund të ndryshojnë jetën tonë. Në rastin tonë, shoku ynë Erjoni, paraqiti imagjinatën e tij se si mund ta shfrytëzojë rrjetin social, për të fituar simpatinë dhe votat e qytetarëve. Në këtë faqe të gazetës do të mund të lexoni më shumë për Kuvendin tonë të dashur

Kosova si shtet demokratik, ka nevojë për ide të reja dhe frymë të re, të cilën mund ta sjellim ne gjeneratat e reja. Çdo qytetar, i cili arrin moshën 18 vjeçare, ka të drejtë të kandidoj për të qenë deputet i Kuvendit të Kosovës. Është zgjedhja jonë nëse dëshirojmë të jemi pjesë e një partie politike, apo dëshirojmë të jemi kandidatë të pavarur.


Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 vende për 120 deputetë. Megjithatë, të gjitha ulëset nuk iu takojnë vetëm shqiptarëve. Prej 120 deputetëve, 10 janë serbë, ndër-

sa 10 të tjerë janë të komuniteteve të tjera jo shumicë. Në këto komunitete hyjnë: komuniteti romë, ashkali, egjiptian, turk, boshnjak dhe ai goran.

Detyrë e deputetëve është që t'i përfaqësojnë qytetarët e Kosovës. Pastaj, të miratojnë apo të mos miratojnë ligje, ta zgjedhin Kryetarin e Kuvendit, Presidentin, Qeverinë, si dhe ta kontrollojnë punën që e bën Qeveria. Ne u kënaqem me rolin e të qenurit gazetarë dhe shpresojmë se ju kemi dhënë informata të mjaftueshme, që do t'iu hyjnë në punë edhe në jetën e përditshme.



Shoqja jonë imagjinare Arta duke hulumtuar në kompjuter



Miku më i ngushtë i njeriut, hyn tek media e shkruar



Demokracia na jep një ndjenjë qetësie në shpirtin tonë



Kurse, bashkëpunimi na orienton drejt suksesit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Medvec, Lipjan